



Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1 nen dhe nen d) të Ligjit nr. 03/L - 040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), dispozitat e nenit 10, të Ligjit nr. 04/L - 144, për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 35/17, dhjetor 2012), në bazë të nenit 20 pikat nga 1 derinë 7 të Rregullorës QRK 23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimit të Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe në bazë të vendimit të Kuvendit të Komunes për lejimin e ndërrimit të destinimit nr.01-06-2357/2016 të miratuar me dt.29.04.2016si dhe paraprakisht kësaj shkreses së Ministrisë së Infrastruktura të dt.04.08.2015 si dhe nenit 46 të Statutit të Komunës së Klinës, 01nr. 01-110-1232/2010, të dt.31.03.2010, Kuvendi i Komunës në seancën e vet të rregullt të VI me radhës të vitit 2016 të mbajtur me datën 24.06.2016, mori këtë:

V E N D I M

Për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës

- I. **APROVOHET**, Propozimi i Kryetarit të Komunës, 01Nr.464-2101/2015, i datës 18.03.2015 që ka të bëjë me marrjen e vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite të pronës së paluajtshme të Komunës, sipas procedurës për raste të veçanta.
- II. Administratës Apostolike të Prizrenit më seli në Prishtinë për nevoja të Famullisë "Zoja e Këshillit të Mirë" më seli në Klinë, i JEPET, në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite pa kompensim, prona e paluajtshme e cila është e evidentuar në emer të Komunës së Klinës dhe atë sipas procedurës për rastet e veçanta të cilat parashihen me nenin 10 të Ligjit për Dhënien në shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së paluajtshme të komunës, si dhe nenin 20 të Rregullores së QRK-së nr.23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së paluajtshme të Komunës.
- III. Prona e paluajtshme e cila jepet në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite, është:
 1. Pjesa e parceles kadastrale, nr.100-2 në sipërfaqe prej 2115 m²(0.21,15 ha) sipas skicës perkatese, e cila evidentohet sipas certifikates për të drejtën e pronësisë nr.10-8918 të datës 14.10.2015, e cila gjendet në ZK në Deiq.
- IV. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës të cekur në pikën III të këtij vendimi, është perkrahja e institucionit fetar të besimit krishter duke i ndare hapsirën tokësore të pronës komunale për ndërtimin e kishës, e cila është edhe kerkese e banoreve si dhe famullisë për ndërtimin e një kishe për aktivitetet fetare të komunitetit vendas të besimit krishter të fshatit Deiq dhe rrethines, realizimi i projektit sipas famullisë bëhet nga nje donator i jashtëm.

- V. Afati kohor dhe menyra e dhënies së pronës së paluajtshme të Komunës është afatëgjatë për periudhen prej nentëdhjet e nentë vite (99) vite pa kompensim, siç është paraparë për rastet e vecanta, perderisa që afati i shfrytëzimit fillon nga data e nënshkrimit të kontratës së shfrytëzimit, e cila me persefermi precizon kushtet dhe kriteret e dhënies në shfrytëzim.
- VI. Të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe përfituesit të pronës së dhënë do të rregullohen me kontratë të veçantë të nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe perfaqesuesi kompetent i marrësit të pronës në shfrytëzim.
- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset: Kryetari i Komunës, organi kompetentë për pronë dhe organi kompetentë për regjistrimin e pronës së paluajtshme.
- VIII. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: kërkesa nr.06/2015 nr. Prot.011-351-2079/15 e dt. 18.03.2015, certifikata pronësore nr.10-8918 e dt.14.10.2015, kopja e planit e dt. 14.06.2016, plani ideor i ndërtimit të objektit, vendimi i Kuvendit të Komunës, nr.01-06-2357/2016 i dt.29.04.2016 lidhur me ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore, si dhe shkresa nderlidhëse e Ministrisë së Infrastruktës e dt.04.08.2015.
- IX. Ky vendim hyn në fuqi me rastin e konfirmimit të ligjshmerisë së tij nga MAPL-ja, përkatësisht 15 ditë pas protokollimit në MAPL.

I'u dërgohet:

- MAPL;
- Kryetarin të Komunës;
- Parashtruesit të kërkesës;
- Shërbimit profesional të Kuvendit;
- Qendrës për shërbime me qytetarë si dhe,
- Arhives.

KUVENDI I KOMUNËS

01Nr. 06-3050 /2016
Klinë, dt. 30/06/2016



Arsy e t i m

Duke marrë parasysh nevojat e besimit fetar katolik të shprehura sipas kërkesës së Administraturës Apostolike të Prizrenit në Prishtinë, përmes Famullisë "Zoja e Këshillit të Mirë në Klinë, e që kanë të bëjnë me dhënien në shfrytëzim afatgjatë të një hapësire publike për ndërtimin e një kishe në fshatin Deiq Komuna e Klinës. Interesimi për ndërtimin e kësaj kishe sipas Famullisë është shprehur fillimisht sipas vetë kërkesave të banoreve të fshatit dhe rrethinës me qëllim të finalizimit të kësaj kërke nga Administratura Apostolike e Prizrenit, përmes donatorit që do të bëjë ndërtimin e kishës si dhe Komuna e Klinës, duke kontribuar në dhënien e një sipërfaqeje tokësore prej 2115 m² (0.21,15 ha) në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite pa kompensim.

Duke parë interesimin e banoreve si dhe gatishmërinë e donatorit për realizimin e projektit Kryetari i Komunës së Klinës, sipas Propozimit nr.01-464-2101/2015 të dt.18.03.2015 i ka propozuar Kuvendit të Komunës dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pjesës së parcelës kadastrale nr.100-2 në sipërfaqe prej 2115 m² sipas skicës përkatëse, e cila evidentohet sipas certifikatës për të drejtën e pronësisë të dt.17.03.2015 e e cila xhindet në ZK Deiq dhe evidentohet si pronë shoqërore.

Me rastin e shqyrtimit të propozimit të kryetarit të komunës, Kuvendi i Komunës pasi shqyrtoj kërkesën si dhe të gjithë dokumentacionin përkatës, në mënyre unanime pa asnjë votë kundër dhe pa asnjë abstenim vendosi që propozimi i kryetarit të aprovohet në tërësi si dhe vendosi që të i JEPET në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite, pa kompensim pjesën e pronësisë lartcekur, sipas specifikimeve tjera të lartë përmendura.

- Sipas nenit 10 paragrafi 1.4 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, Ligji nr.04/L-144 thuhet decidivisht se për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës për rastet e veçanta nuk zbatohen procedurat e konkurrimit në rast se kemi të bëjmë me dhënien në shfrytëzim të pronës, për bashkësitë fetare për zhvillimin e aktiviteteve fetare (neni 10 pika 1.4 e Ligjit nr.04/L-144).

- Sipas nenin 10 të ligjit pika 1.6 thotë se procedurat për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme për rastet e veçanta do të përcaktohen me akt nënligjore, ku me pastaj në vitin 2013 rrjedh nga QRK Rregullorja nr.23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Ku neni 20 parasheh dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për rastet e veçanta, ku decidivisht sipas nenit 20 paragrafi 3 pika 3.3 thuhet se dhënia e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim për rastet e veçanta, bëhet konform kërkesave më shkrim të cilat paraqiten nga: Bashkësitë fetare për nevoja të zhvillimit të aktiviteteve fetare (neni 20 pika 3.3 e Rregullores së QRK nr.23/2013).

E gjithë rrjedha e procedurës për dhënien në shfrytëzim të kësaj prone ka shkuar në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës nr.04/L-144, Rregullores së QRK-së nr.23/2013 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës si aktet tjera ligjore dhe nënligjore që rregullojnë çështjen shfrytëzimit të pronës komunale.

Bashkangjitur vendimit do të jenë të gjitha aktet paraprake të cilat kanë ardhur deri të finalizimi i vendimit të Kuvendit të Komunës.